



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KLOS

Nr. 1546 prot.

VENDIM

Nr. 38. Date 08/07/2019

**"Për miratimin e Planit të Detajuar Vendor në Njësinë me kod KL/UB437, sipas
Planit Përgjithshëm Vendor "**

Mbështetur në autoritetin e Kryetarit të Bashkisë Klos dhe në zbatim të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 " Për veteqeverisjen vendore " në ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ", i ndryshuar : në VKM nr.408, datë 13.05.2015, " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ", i ndryshuar , në VKM nr. 686 , datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit"; në VKM nr. 1096, datë 28.12.2015, "Për miratimin e rregullave, kushteve, procedurave përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike" dhe me PPV-në e miratuar me vendim KKT Nr. 1, Datë 27.04.2018 dhe interesin e Bashkisë Klos:

VENDOSA:

1. Të miratoj Planin e Detajuar Vendor për njësinë strukturore me kod KL/UB437,
2. Plani i Detajuar Vendor me kod KL/UB 437 përbëhet me dokumentat si vijon:
 - Nisma e Kryetarit të bashkisë për hartimin e PDV-së me kod KL/UB437
 - Relacioni dhe rregullorja e PDV, Faza I dhe Faza II
 - Materiali Hartografik
 - Korospondenca me institucionet
3. Gjatë miratimit të lejeve të zhvillimit dhe lejeve të ndërtimit, Drejtoria e Përgjithshme e Territorit dhe Projekteve duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga PDV-ja.

4. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit të Territorit për zbatimin e PDV-së me kod KL/UB437.
5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Territorit dhe Projekteve që një kopje e materialit në format shkresor dhe elektronik të PDV-së me kod KL/UB 437 t'a dorëzojë në Z.V.R.P.P Mat.

P/Urbanistikës dhe Zhvillimit të Territorit

Amareta MIRDITA

Amareta
Mirdita

Digitally signed by
Amareta Mirdita
Date: 2019.07.08
10:57:59 +02'00'

KRYTARI I BASHKISË

